



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 344/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e OJQ-CRZD dega në Leposaviq, paraqitur kundër Qendrës së Votimit në Leposaviq për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

**HIDHET** si e pas afatshme ankesa e OJQ “CRZD” në Leposaviq.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 10.06.2014, nga OJQ “CRZD” ku theksohet se me datën 08.06.2014, në Qendrat e Votimit iu kanë pamundësuar vëzhguesve të tyre të jenë prezent para dhe pas mbylljes së (QV) si dhe gjatë votimit është bërë vjedhja e votave dhe është vërtetuar se ka munguar një numër i madh i fletëvotimeve.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e pas afatshme**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme ngase afati për të parashtruar ankesë në PZAP për të gjitha parregullsite që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: “*Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelje ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit*”. Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP me datë 10.06.2014 në ora 17:45, që nënkupton se është pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërsëhënuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 344/2014 më datën 12.06.2014



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.